

V E N D I M
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE
TE SHOQERISE FINMAN SH.P.K.

Finman Sh.p.k., nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit ("QKB"), me NUIS L62405030K, me seli ne Sheshin "Italia", Arena Center, Seksioni D, Kati i 5^{te}, Tirane ("Shoqeria" ose "Finman").

Vendi: Selia e Shoqerise, ne adresen: *Sheshi "Italia", Arena Center, Seksioni D, Kati i 5^{te}, Tirane*

Data: 14/12/2021

Rendi i Dites:

1. Zvogelim i kapitalit te Shoqerise;
2. Te ndryshme.

* * *


Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te Shoqerise perbehet nga ortaket e saj, te cilet jane te gjitha rregullisht te pranishem ne mbledhje ("Ortaket"), si vijon:

1. Z. Idajet Ismailaj, i cili zoteron 56,25% te kapitalit te Shoqerise;
2. Z. Sadik Ismailaj, i cili zoteron 31,25% te kapitalit te Shoqerise;
3. Z. Jonuz Ismailaj, i cili zoteron 6,25% te kapitalit te Shoqerise; dhe
4. Znj. Rajmonda Agalliu, e cila zoteron 6,25% te kapitalit te Shoqerise.

Mbledhja e Pergjithshme e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise eshte thirrur rregullisht dhe mbahet ne perputhje me Statutin e Shoqerise ("Statuti") dhe Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar ("Ligji Tregtar").

DUKE QENE SE:

- A. Kapitali i Shoqerise eshte aktualisht 90,000,000 (nentedhete milion) Leke.
- B. Ortaket e Shoqerise deshirojne qe te zvogelojne kapitalin e Shoqerise me vleren prej 1,000,000 (nje milion) milione Leke.
- C. Zvogelimi i kapitalit do te kryhet nepermjet anulimit te pjesshem (*ulja e vleres*) te kuotes se secilit Ortak, *ne menyre proporcionale*.
- D. Ne daten e themelimit, kapitali i Shoqerise eshte financuar me kontribut ne natyre nga ortaket themelues, financim i cili perbehej nga 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar Vibtis Sh.p.k. ("Vibtis"). Ky kontribut ne natyre referohet ne vijim si "Financimi".



miratim
shoqer

- E. Ortaket e Shoqerise deshirojne qe te percaktojne modalitetet e pageses ne lidhje me zvogelimin e kapitalit ("Modalitetet e Pageses"), duke qene se Ortaket do te paguhen ne natyre duke u kthyer mbrapsht atyre Financimin (gjithashtu kontribut ne natyre ne castin e themelimit te Shoqerise), pra duke i kthyer Ortakeve kuoten perkatese tek shoqeria Vibtis ("Kuota Vibtis").
- F. Gjithashtu, per efekt te permbushjes se Modaliteteve te Pageses per shkak te zvogelimit te kapitalit, Ortaket do te miratojne kontraten per kalimin e Kuotes Vibtis tek secili Ortak ("Kontrata e Kalimit te Kuotes Vibtis"), ne menyre qe secili Ortak te regjistroje prane QKB-se ne lidhje me shoqerine Vibtis, Kuoten Vibtis qe i takon.

PER KETO ARSYE, Asambleja e Ortakeve UNANIMISHT,

V E N D O S I:

1. Te miratojne zvogelimin e kapitalit te Shoqerise me vleren prej 1 (nje) milione Leke dhe per kete shkak kapitali i ri i Shoqerise, pas regjistrimit te ketij Vendimi prane QKB-se, eshte 89,000,000 (tetedhjete e nente milione) Leke.
2. Te miratojne anulimin e pjesshem (*uljen e vleres*) te kuotes se secilit Ortak, *ne menyre proporcionale*, per shkak te zvogelimit te kapitalit te Shoqerise sipas pikes 1 te ketij Vendimi.
3. Te miratojne zvogelimin e kapitalit dhe per shkak te anulimit te pjesshem te kuotes se secilit Ortak te Shoqerise, sipas pikes 2 te ketij Vendimi pas regjistrimit te zvogelimit te kapitalit, vlera nominale e kuotes se secilit Ortak ne Finman eshte si vijon:
 - (i) Z. Idajet Ismailaj, zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 50,062,500 Leke (pesedhjete milion e gjashtedhjete e dy mije e peseqind leke), qe perfaqeson 56,25% te kapitalit te Shoqerise;
 - (ii) Z. Sadik Ismailaj, zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 27,812,500 Leke (njezete e shtate milion e teteqind e dymbedhjete mije e peseqind leke), qe perfaqeson 31,25% te kapitalit te Shoqerise;
 - (iii) Z. Jonuz Ismailaj, zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 5,562,500 Leke (pese milion e peseqind e gjashtedhjete e dy mije e peseqind), qe perfaqeson 6,25% te kapitalit te Shoqerise; dhe
 - (iv) Znj.Rajmonda Agalliu, zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 5,562,500 Leke (pese milion e peseqind e gjashtedhjete e dy mije e peseqind leke), qe perfaqeson 6,25% te kapitalit te Shoqerise.
4. Te miratojne Modalitetet e Pageses per zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, si vijon:
 - 4.1 Shoqeria do t'i paguaje Ortaket (*jo ne te holla por*) ne natyre per efekt te zvogelimit te vleres nominale te kuotes se secilit sipas pikes 2 dhe 3 te ketij Vendimi ketu me siper;

Saukaj
Babali


- 4.2 Pagesa ne natyre perbehet nga kthimi i Financimit tek Ortaket, duke i kaluar secilit Ortak Kuoten Vibtis qe i takon sipas Raportit te Zvogelimit te Kapitalit.
5. Te miratojne Kontraten e Kalimit te Kuotes Vibtis per secilin Ortak per efekt te permbushjes se Modaliteteve te Pageses sipas pikes 4 te Vendimit ketu me siper dhe te autorizojne administratorin e Shoqerise qe te nenshkruaje me secilin Ortak respektivisht Kontraten e Kalimit te Kuotes Vibtis qe i takon respektivisht.
6. Te autorizojne administratorin e Shoqerise Z. Idajet Ismailaj, shtetas shqiptar, lindur me 22.01.1963, identifikuar me nr.personal G301220100, te kryeje vete apo permes delegimit/autorizimit tek te tretet, cdo veprim per regjistrimin e ketij Vendimi prane QKB-se, ose prane cdo autoriteti tjeter kompetent dhe per kete arsye, te pergatise, hartoje, nenshkruaje, plotesoje cdo kerkese, formular, aplikim, etj. ose te permbushe cdo procedure tjeter ligjore ne menyre qe te permbushet qellimi i ketij Vendimi dhe regjistrimi i suksesshem i tij sipas ligjit.

Asnje vendim tjeter nuk u mor ne kete Mbledhje te Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.


NE DESHMI TE SA ME SIPER, ne Ortaket e Shoqerise, te pranishem ne Mbledhjen e Pergjithshme te Asamblese te shoqerise Finman Sh.p.k., nenshkruajme rregullisht kete dokument te hartuar ne 4 (kater) kopje origjinale me vlere te barabarte ligjore.

ORTAKET


Idajet Ismailaj




Sadik Ismailaj



Jonuz Ismailaj



Rajmonda Agalliu



Saulo
20/04/2016